



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 55 regjistër (JR)
Datë 29.10.2019

Nr. 12 i vendimit
Datë 12.05.2021

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Ardian Hajdari	Relator
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 12.05.2021, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 55/2019 (JR), datë 29.10.2019, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 173, datë 01.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Artan Madani.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 173, datë 01.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Artan Madani, dhe shkarkimin e tij nga detyra, dëgjoi subjektin e rivlerësimit dhe avokatin e tij Klodjan Skënderaj, të cilët gjatë dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor kërkuan lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Ardian Hajdari, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Artan Madani (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
2. Më parë, në funksion dhe për zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), sipas të cilave ka rezultuar:

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- (i) **deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;**
- (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- (iv) *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

¹ Raporti i ILDKPKI-së nr. {***}, datë 19.01.2018.

2.2 DSIK-ja kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dërgoi raportet² pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, duke vlerësuar papërshtatshmërinë për vijimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit.

2.3 GPPP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga vetë subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, duke dërguar pranë Komisionit një raport³ të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe GPPP-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e rivlerësimit (të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale) dhe mori vendimin objekt shqyrtimi nr. 173, datë 01.07.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, me vendimin nr. 173, datë 01.07.2019, ka vendosur: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Artan Madani, me funksion prokuror/drejtues në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë.
5. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

5.1. Në lidhje me vlerësimin e pasurisë: [...] Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, mbështetur në faktin se deklarimet e pasakta të konstatuara në deklarimet ndër vite nuk cenojnë detyrimin e tij kushtetues për deklaram të saktë në deklaratën “vetting”, Komisioni çmon se pasaktësitë e konstatuara nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, si dhe nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut te drejtësia. Komisioni vlerëson gjithashtu se pamjaftueshmëria që rezulton nga analiza financiare, nuk është e një madhësie të tillë që të sjellë lindjen e dyshimeve për veprime që cenojnë figurën e prokurorit. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

² Raporti fillestar nr. {***} prot., datë 02.11.2017, si dhe raporti i rishikuar me nr. {***}, datë 07.01.2019, për subjektin e rivlerësimit Artan Madani.

³ Raporti i GPPP-së me nr. {***} prot., datë 18.10.2018, për subjektin e rivlerësimit Artan Madani.

5.2. Në lidhje me kontrollin e figurës: Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha provave, fakteve dhe bazuar në legjislacionin në fuqi, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës. Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016.

5.3. Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale: Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe pesë denoncimeve të depozituara ndaj këtij subjekti në Komision, trupi gjykues nuk gjeti asnjë indice apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit. Mbështetur në raportin e Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe shqyrtimin e pesë denoncimeve, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional. Nga sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të shkronjës “c”, të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016.

Shkaqet e ankimit

6. Komisioneri Publik Florian Ballhysa (në vijim “Komisioneri Publik”) ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 173, datë 01.07.2019, për subjektin e rivlerësimit, duke konsideruar se ndryshe nga sa disponon Komisioni për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan qëndrim të kundërt, pasi vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë.
7. Komisioneri Publik kërkoi që shkaqet e këtij ankimi t’i marrë në shqyrtim Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:
 - *Ndryshimin e vendimit nr. 173, datë 01.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artan Madani.*
8. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik paraqiten në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.

Shkaqe ankimi që lidhen me kontrollin e pasurisë

9. Lidhur me pasurinë “apartament banimi” me sipërfaqe 146,46 m², në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me bashkëshorten, ndodhur në zonën kadastrale nr. {***}, rruga “{***}”, Durrës dhe pasurinë “garazh” me sipërfaqe 10,5 m², ndodhur në zonën kadastrale nr. {***}, rruga

“{***}”, Durrës, Komisioneri Publik pretendon se konkluzioni i Komisionit nuk qëndron, pasi nuk bazohet në një vlerësim të drejtë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të dala nga aktet e administruara në dosje, si dhe niset nga një premisë e gabuar për t’i dhënë vlerë provuese nivelit deklarativ të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, për sa i përket (i) gjendjes “karabina” të pasurisë “Apartament banimi 146 m²”; (ii) lapsusit/harresës për mosdeklarimin e pasurisë “Garazh 10 m²”; (iii) dhe kontributeve të padeklaruara më parë të të afërmeve të tij, të cilat nuk janë në harmoni me provat e administruara në Komision gjatë hetimit administrativ; (iv) shpenzimeve të jetesës për periudhën 1992-1997. Komisioneri Publik gjen të pabazuar konkluzionin e Komisionit për këtë pasuri, në lidhje me metodologjinë për llogaritjen e shpenzimeve dhe koston e jetesës për person për periudhën para vitit 2003. Ky vlerësim i Komisionit ka sjellë si pasojë dhe një qasje të gabuar në kryerjen e analizës financiare, ku për vite me radhë Komisioni ka llogaritur vetëm të ardhurat (1992-1997), pa përfshirë në analizë asnjë shpenzim për jetesë nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe e familjes së tij. Komisioneri Publik, pasi konstaton faktet dhe rrethanat lidhur me krijimin e pasurisë së parë, duke i renditur ato në mënyrë kronologjike dhe të përmbledhur, ngre pretendimet e mëposhtme.

9.1 Komisioneri Publik pretendon se nga shqyrtimi i akteve në dosje, apartamenti me sip. 146 m² nuk rezulton të jetë blerë në gjendjen “karabina”, pasi nga përmbajtja e kontratave nuk është parashikuar i tillë apo gjendje “e papërfunduar” e pasurive të shitura, si dhe është provuar që subjekti i rivlerësimit e ka blerë të përfunduar plotësisht apartamentin në vitin 2000. Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit mundohet të provojë një fakt të ndryshëm nga përmbajtja e kontratave noteriale të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme dhe e akteve të tjera zyrtare, të cilat në kuptim ligjit përbëjnë provë të plotë.

9.2 Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit ka dy certifikata pronësie të ndryshme, ka paguar për secilën nga pasuritë dy vlera të ndryshme blerjeje, të dyja pasuritë regjistrohen secila më vete në ZVRPP Durrës, ku aplikimi për regjistrimin e pasurisë garazh me sip. 10 m² rezulton se është bërë nga vetë subjekti i rivlerësimit, ndaj pretendimi i tij se kjo pasuri mendohej e lidhur me pasurinë apartament banimi nuk është i vërtetë dhe as i bazuar në prova.

9.3 Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme nga burime të ligjshme krijimin e pasurisë apartament + garazh. Komisioneri Publik, lidhur me burimin e të ardhurave të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive çmon se, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, nuk duhet të konsiderohen si të ardhura të ligjshme (i) dhurimet nga të afërmit e subjektit të rivlerësimit, në shumën totale 3.150.000 lekë, si dhe (ii) të përfshihen në analizë shpenzimet e jetesës për periudhën 1992-1997. Në këto kushte, balanca negative e të ardhurave të ligjshme për subjektin e rivlerësimit për periudhën 1992-2003, sipas pretendimit të Komisionerit Publik, arrin në vlerën negative 4.230.853 lekë.

10. Lidhur me Fondin e Investimeve “{*}”** në shumën 5.500.000 lekë në Raiffeisen Bank dhe për krijimin e gjendjes *cash* në banesë të deklaruar në shumën 1.200.000 lekë, Komisioneri Publik ka

ngritur si shkak ankimi mungesën e të ardhurave të ligjshme nga burime të ligjshme për investimin e kryer, si dhe rezultatet e analizës së treguesve financiarë ndër vite.

11. **Lidhur me pasurinë e luajtshme autoveturë e markës “Ford”**, me targë {***}, në pronësi të shtetasit A. L., Komisioneri Publik nëpërmjet këtij shkaku ankimi pretendon se subjekti i rivlerësimit në lidhje me përdorimin e automjetit në fjalë, është në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe fshehjes së ushtrimit të të drejtave mbi këtë send.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

i. Juridiksioni i Kolegjit

12. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

13. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

14. Në përputhje me nenin 65⁴, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 173, datë 01.07.2019, për subjektin e rivlerësimit Artan Madani, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve.

⁴ *Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.*

B. Mbi aspektet procedurale lidhur me provat dhe kërkesat e Komisionerit Publik dhe atyre të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor, Kolegji konstaton si më poshtë.

15. Komisioneri Publik, në parashtrimet e depozituara në Kolegji që mbajnë datën 18.03.2021, pasi u shpreh se u qëndron shkaqeve të ankimit, mbështetur në parashikimet e nenit F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit.
16. Në seancën gjyqësore publike të datës 18.03.2021, subjekti i rivlerësimit, me parashtrimet e tij të depozituara në Kolegji, kërkoi riçeljen e hetimit gjyqësor, si dhe marrjen në shqyrtim në seancë gjyqësore të provave të depozituara, një pjesë e të cilave, që plotësonin kushtet formale ligjore, u pranuan nga Kolegji në këtë seancë gjyqësore dhe renditen si më poshtë.
 1. Lista e kontratave të shitblerjeve të apartamenteve në pallatin “{***}”, e konfirmuar me shkresën nr. {***} prot., datë 28.07.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, bashkëlidhur dokumentacioni tekniko-ligjor i regjistrimit të pasurisë, si dhe kontrata e shitjes së apartamentit ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” ShPK.
 2. Printime nga sistemi TIMS i raportit të shtetasit A. L.
 3. Printime nga sistemi TIMS i raportit të subjektit të rivlerësimit Artan Madani.
 4. Lista e kërkimit në sistemin e menaxhimit të kontratave për vitet 2001-2004 të pallatit, sipas shkresës nr. {***} prot., datë 23.07.2020, nga OSSH Durrës.
 5. Deklaratë noteriale e S. M., nr. {***} rep., {***} kol., datë 26.01.1998.
 6. Fotografi të garazhit (4 foto).
 7. Analiza financiare për periudhat 1992-2003, 2004-2016 dhe e vitit 2011.
 8. Vërtetim nr. {***} prot., datë 16.02.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, për të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga paga, dieta, bonusi i karburantit dhe shpërblime.
 9. Deklaratë noteriale e z. A. M., me nr. {***} rep., {***} kol., datë 29.12.2020.
 10. Deklaratë noteriale e z. E. K., me nr. {***} rep., {***} kol., datë 06.07.2020.
 11. Deklaratë noteriale e z. I. D., me nr. {***} rep., {***} kol., datë 14.08.2020.
 12. Deklaratë noteriale e kryer në Itali nga A. L., datë 16.07.2020, me vulë apostile, e përkthyer në shqip dhe e noterizuar.
17. Në seancën gjyqësore publike të datës 13.04.2021, subjekti i rivlerësimit paraqiti për administrim dhe shqyrtim nga ana e Kolegjit, provat e mëposhtme.
 1. Kontratë e lidhur në shtetin italian për shitblerjen e apartamentit të z. E. K. në Itali, me nr. rep. {***}, dhe kol., {***}, datë 23.12.2003, dokument i cili mban vulën apostile, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.
 2. Certifikatë kontekstuale e rezidencës, gjendjes familjare dhe gjendjes civile, e z. I. D., lëshuar nga Komuna e {***} më datë 19.03.2021, dokument i cili mban vulë apostile, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.

3. Certifikatë historike e rezidencës {***}, e z. I. D., lëshuar më datë 19.03.2021, dokument i cili mban vulën apostile, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.
 4. Kontratë e lidhur në shtetin italian për shitblerjen e apartamentit të z. I. D., në Itali, me nr. rep {***}, dhe kol., {***}, datë 29.10.2003, dokument i cili mban vulë apostile, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.
 5. Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, me nr. serie {***}, datë 10.11.2020, me emër të siguruari A. L.
 6. Vërtetim i njësisë me origjinalin për deklaratën noteriale të A. L., me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 24.01.2017.
 7. Procesverbal për bërje inventari për evidentimin e materialit të përcjellë me postë elektronike nga një zyrë avokatie në Athinë, Greqi, procesverbal i cili është hartuar para noterit dhe mban nr. {***} rep., {***} kol., datë 12.04.2021.
- 18.** Në seancën gjyqësore publike të datës 22.04.2021, subjekti i rivlerësimit paraqiti edhe provat të cilat i kishte lënë detyrë Kolegji në seancën e datës 18.03.2021 që të paraqiten në formën e kërkuar nga ligji, dhe janë si në vijim.
1. Deklarata e përgjegjësisë e shtetasit A. M., e lëshuar pranë Autoritetit të Pavarur të të Ardhurave Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Administratës Tatimore, Athinë, Greqi, më datë 14.04.2021, dokument i cili mban vulë apostile, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.
 2. Deklaratë përgjegjësie e shtetasës A. M., e lëshuar më datë 10.09.2020 pranë Drejtorisë së Qendrave të Shërbimit të Qytetarëve, Athinë, Greqi, dokument i cili mban vulë apostile, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.
 3. Akti i përcaktimit administrativ të tatimit në bazë të deklaratës fillestare të shtetasit A. M., lëshuar më datë 13.04.2021, dokument i cili mban vulë apostile, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.
 4. Llogaritë bankare të shtetasit A. M., për periudhën 2002 – 2021, dokument i cili mban vulë apostile, i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.
 5. Leje qëndrimi e shtetasit A. M., e përkthyer në gjuhën shqipe.
- 19.** Kolegji riçeli shqyrtimin gjyqësor për të hetuar faktet e pretenduara në ankim, duke i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të shpjegohet në lidhje me to. Bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në seancë publike në Kolegji, të listuara më sipër, për sa ato lidheshin me shkaqet e ankimit dhe nevojën e subjektit të rivlerësimit për t'i prapësuar ato, në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, Kolegji vendosi të lejojë marrjen dhe nënshtrimin e tyre debatit gjyqësor e më pas i vlerësoi ato në raport me vendimin objekt shqyrtimi dhe shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik. Pasi u vlerësuan edhe provat e reja të sjella nga subjekti i rivlerësimit, në formën e kërkuar nga ligji, të cilat iu nënshtruan debatit gjyqësor, Kolegji arriti në konkluzionet e mëposhtme.

Kontrolli i kriterit të pasurisë

20. Pasuria “apartament banimi”, me sipërfaqe 146,46 m², nr. {***}, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit me bashkëshorten, ndodhur në rrugën “{***}”, Durrës, blerë me kontratën e shitblerjes me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., e datës 01.10.2004, dhe pasuria “garazh” nr. {***}, me sipërfaqe 10,5 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Durrës.
21. Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Si përfundim, Komisioni çmon se, pavarësisht se analiza financiare për periudhën 1992 – 2003 del me një balancë negative të fondeve në vlerë të vogël, nuk mund të vihet në dyshim aftësia financiare e subjektit për kryerjen e pagesave për prenotimin e këtyre pasurive dhe realizimin e shpenzimeve për përfundimin e apartamentit, kjo nisur edhe nga fakti se vlera totale e deklaruar e këtyre pasurive është e karakterit deklarativ dhe nuk disponohet ndonjë evidencë apo situacion punimesh lidhur me shpenzimet totale të kryera nga subjekti i rivlerësimit për përfundimin e apartamentit. Duhet pasur parasysh që analiza financiare para vitit 2003 nuk ka një bazë të saktë për llogaritjeje, duke qenë se Komisioni nuk disponon të dhëna të sakta në lidhje me shpenzimet dhe koston e jetesës për person. Në këtë rast, balanca negative është -163.765 lekë për 10 vjet, pra, rreth 16.000 lekë në vit, vlerë e cila mund të jetë marzhi i gabimit në përlllogaritje dhe, për këtë arsye, nuk do të merret në konsideratë. Si rrjedhim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për kryerjen e pagesave për prenotimin dhe realizimin e shpenzimeve për pasuritë apartament + garazh.*
22. Komisioneri Publik, për këtë pasuri, pretendon se konkluzioni i Komisionit nuk qëndron, pasi nuk bazohet në një vlerësim të drejtë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të dala nga aktet e administruara në dosje, si dhe nisur nga një premisë e gabuar për t’i dhënë vlerë provuese nivelit deklarativ të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, për sa i përket, në mënyrë të përmbledhur: (i) gjendjes “karabina” të pasurisë “Apartament banimi 146 m²”; (ii) lapsusit/harresës për mosdeklarimin e pasurisë “Garazh 10 m²”; (iii) dhe kontributeve të padeklaruar më parë të të afërmeve të tij, të cilat nuk janë në harmoni me provat e administruara në Komision gjatë hetimit administrativ; (iv) shpenzimeve të jetesës për periudhën 1992-1997. Komisioneri Publik gjen të pabazuar konkluzionin e Komisionit për këtë pasuri, në lidhje me metodologjinë për llogaritjen e shpenzimeve dhe koston e jetesës për person për periudhën para vitit 2003. Ky vlerësim i Komisionit ka sjellë si pasojë dhe një qasje të gabuar në kryerjen e analizës financiare, ku për vite me radhë Komisioni ka llogaritur vetëm të ardhurat (1992-1997), pa përfshirë në analizë asnjë shpenzim për jetesë nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe e familjes së tij. Komisioneri Publik, pasi konstaton faktet dhe rrethanat lidhur me krijimin e pasurisë së parë, duke i renditur ato në mënyrë kronologjike dhe të përmbledhur, ngre pretendimet e mëposhtme.
23. Komisioneri Publik pretendon se nga shqyrtimi i akteve në dosje, apartamenti me sip. 146 m² nuk rezulton të jetë blerë në gjendjen “karabina”, pasi nga përmbajtja e kontratave nuk është parashikuar i tillë apo gjendje “e papërfunduar” e pasurive të shitura, si dhe është provuar që

subjekti i rivlerësimit e ka blerë të përfunduar plotësisht apartamentin në vitin 2000. Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit mundohet të provojë një fakt të ndryshëm nga përmbajtja e kontratave noteriale të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, dhe akteve të tjera zyrtare, të cilat në kuptim të ligjit përbëjnë provë të plotë.

23.1 Kolegji vëren se nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar Komisionit nga ZVRPP Durrës, konfirmohet se këto pasuri janë: (1) apartament banimi me sip. 146,46 m², blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, nëpërmjet kontratës noteriale të shitblerjes me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., të datës 01.10.2004; si dhe (2) garazh me sip. 10,5 m², blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, nëpërmjet kontratës noteriale të shitblerjes me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., të datës 01.10.2004. Rezulton se këto dy pasuri janë regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit në datën 24.11.2004. Nga përmbajtja e këtyre kontratave është përcaktuar se apartamenti është blerë me çmimin 1.700.000 lekë, ndërsa garazhi me çmimin 250.000 lekë.

23.2 Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë: *Apartament banimi me sip. 146,23 m², dhe garazh 10,5 m², burimi i krijimit: (i) nga kursimet në vite e të ardhurave; (ii) pjesëtimi vullnetar nga shitja e banesës së prindërve në vitin 2000. Vlera sipas aktit të porosisë së vitit 2001 është 5.500.000 lekë, ndërsa për arsye të mospërfundimit të banesës, në aktet e shitblerjes vlera e apartamentit (karabina) është 1.700.000 lekë dhe vlera e garazhit është 250.000 lekë, shpenzime të cilat janë kryer më pas për punimet [...].*

23.3 Në deklaratën fillestare të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: apartament banimi 3+1, vlera 5.500.000 lekë dhe burimi i krijimit: (i) nga kursimet në vite e të ardhurave; (ii) pjesëtimi vullnetar nga shitja e banesës së prindërve në vitin 2000.

23.4 Kolegji konstaton se nga të dhënat që rezultojnë më sipër nga deklaratimet dhe dokumentacioni i administruar në dosje, vërehet se ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit me provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit lidhur me vlerën e deklaruar të këtyre pasurive. Në përgjigjet e datës 10.10.2018 të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, subjekti i rivlerësimit në lidhje me pyetjet e Komisionit për këto mospërputhje ka sqaruar se: *Kur kam deklaruar në vitin 2004 për vlerën e banesës në shumën 5,5 milionë lekë, kam pasur parasysh vlerën reale të objektit tashmë të përfunduar, në të cilën përfshihej pagesa e bërë sipas porosisë së marrëveshjes verbale në vitin 2001 që kisha rënë dakord me firmën dhe që u formalizua në kontratën e vitit 2004 [...]. Diferenca në vlerë ka ardhur si rezultat i punimeve të bëra për përfundimin e banesës nga viti 2001-2003. Apartamentin e kam marrë në fazë karabinaje dhe punimet i kam kryer më pas në kohë, deri kur kam hyrë në banesë.*

23.5 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i ZVRPP-së Durrës, i administruar në dosjen e Komisionit, në praktikën e regjistrimit të godinës 8-katëshe të firmës “{***}”, gjendet procesverbali i kolaudimit të kësaj godine ku, ndër të tjera, specifikohet se punimet e objektit kanë përfunduar në datën 30.09.2000. Gjithashtu, më datë 20.09.2000, është lëshuar edhe leja e shfrytëzimit (banimit), me anë të së cilës Seksioni i Urbanistikës Durrës, mbështetur në

procesverbalin e kolaudimit, ka vendosur që firma “{***}” ShPK të fillojë shfrytëzimin (banimin) e objektit. Bazuar në ligjin nr. 7720, datë 14.6.1993, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve” i ndryshuar, në nenin 12 parashikohet se: “Dhënia e lejes së shfrytëzimit ose të banimit bëhet nga seksioni i urbanistikës pas depozitimit të procesverbalit të kolaudimit”.

23.6 Subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e paraqitura prej tij në Kolegj në seancën gjyqësore publike të datës 18.03.2021, lidhur me këtë shkak ankimi është shprehur: *Vërtetohet plotësisht nga kontrata e lidhur e energjisë elektrike që unë së bashku me familjen time kam hyrë në banesë në muajin janar të vitit 2004 (pra mbi dy muaj përpara deklaramentit të parë, DPV-së të vitit 2004). Për saktësi, kam parasysh dhe përgjigjen nr. {***}, datë 16.01.2019, ardhur nga OSHEE - Tiranë, sipas kërkesës së Komisionit gjatë hetimit administrativ. [...] Pra, pretendimi i Komisionerit se unë kam filluar të banoj që në vitin 2000 në këtë banesë është tërësisht i pavërtetë, dhe pa iu referuar asnjë fakti që ka lidhje me banimin, por thjesht se pallati ka përfunduar në atë vit sipas regjistrimit të pallatit.*

23.7 Komisioneri Publik lidhur me këtë fakt, në qëndrimet e tij të datës 22.04.2021, gjatë seancës gjyqësore publike në Kolegj sqaroi se: “[...] në ankimin e Komisionerit Publik, nuk pretendohet se subjekti i rivlerësimit ka filluar të banojë në apartamentin e banimit me sip. 146 m² që në vitin 2000, por se gjendja juridike/ligjore e kësaj pasurie, në vitin 2000 nuk rezulton si “karabina” në aktet zyrtare”.

23.8 Kolegji konstaton se pjesë e praktikës së regjistrimit të godinës së ndërtuar nga firma “{***}” ShPK është edhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me nr. {***}, datë 31.08.2001, nëpërmjet të cilit gjykata ka vendosur pranimin e kërkesë padisë së paditësit shoqërisë “{***}” ShPK, duke detyruar të paditurin ZVRPP Durrës të bëjë regjistrimin në pronësi të paditësit të banesës 8-katëshe dhe katin nën tokë, ndër të tjera me arsyetimin se: *[...] Ndërtimi i banesës është bërë me leje të organeve kompetente shtetërore, ka përfunduar dhe është dhënë për shfrytëzim, ndërsa çështja e kateve është zgjidhur me vendim të gjykatës, i cili ka marrë formë të prerë, prandaj dokumentacioni për regjistrimin e saj në ZVRPP është i plotë [...]. Gjithashtu deklarata noteriale e datës 08.01.2001, me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., e shoqërisë “{***}” ShPK, administratorit të saj z. N. J., ka objekt regjistrimin e godinës së banimit duke dhënë detaje të ndërtesës, por në asnjë vend nuk përmendet që godina është karabina, përkundrazi referohet si banesë 8-katëshe. Në dokumentacionin e ZVRPP-së Durrës gjendet edhe vërtetimi nga dokumentet hipotekore i lëshuar më datë 26.02.2004 nga ZVRPP Durrës, sipas të cilit shoqëria “{***}” ShPK ka regjistruar këtë pasuri në regjistrin hipotekor nr. {***}, më datë 06.12.2001.*

23.9 Kolegji vëren se nga provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, në seancën e datës 18.03.2021, në grup-provat “Kontratat e shitblerjeve të apartamenteve nga banorët bashkë me praktikat ku pasqyrohet çmimi dhe sipërfaqja” rezulton se në këtë listë një shtetas (L. H.), i cili e ka blerë apartamentin nga e njëjta shoqëri, ka lidhur kontratën e shitblerjes në datën 23.06.2005 dhe sipërfaqja e apartamentit është 100 m² + 10,5 m² garazh, blerë me çmimin 43.500 USD, në një kohë që në të njëjtën periudhë një tjetër blerës (H. Xh.) e ka blerë apartamentin

me sip. 154 m² + garazh 10,5 m², me vlerë 1.800.000 lekë. Kjo e fundit e lidhur me datë 29.06.2005, në një hark kohor relativisht të afërt me kontratën e subjektit të rivlerësimit, me vlera të ndryshme dhe diferenca të mëdha të çmimit të blerjes, krijon bindjen se apartamentet nuk ishin në gjendje karabinaje. Nga këto kontrata, kuptohet se në të njëjtin vit blerjeje të apartamenteve (2005) ka vlera të ndryshme çmimesh, çka do të thotë se z. Xh. nuk e ka blerë në gjendje karabina, edhe pse çmimi i blerjes së apartamentit të tij është i përafërt me atë të blerjes së apartamentit nga subjekti i rivlerësimit, pasi blerësi tjetër, z. H., e ka blerë me një çmim më shumë se dyfishi i çmimit të apartamenteve të tyre. Gjendja karabina është për të gjithë blerësit ose për asnjërin, pasi është një gjendje ndërtimi e përgjithshme e pallatit.

23.10 Kolegji arrin në konkluzionin se nga dokumentacioni i sipërcituar, rezultoi që kjo godinë ishte përfunduar përpara regjistrimit të saj në regjistrin hipotekor me nr. {***}, datë 06.12.2001, me pronar shoqërinë ndërtuese “{***}” ShPK. I gjithë dokumentacioni i cituar në paragrafin 23.5 më sipër, i cili ka shërbyer për regjistrimin e kësaj godine e trajton si ndërtim të përfunduar dhe në gjendje teknike për shfrytëzim/banim. Si rrjedhojë, pretendimet e subjektit se apartamentin e ka blerë në gjendje “karabina” nuk u mbështetën nga rrethanat e rezultuara, sipas dokumenteve të administruara dhe as nga provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në Kolegji, duke mos arritur të provonte se apartamenti ishte në gjendjen karabina në momentin që subjekti deklaroi se ka lidhur kontratën verbale të pasurisë, ndaj *shkaku i ankimit i ngritur nga Komisioneri Publik gjendet i bazuar.*

- 24.** Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit ka dy certifikata pronësie të ndryshme, ka paguar për secilën nga pasuritë dy vlera të ndryshme, të dyja pasuritë janë regjistruar secila më vete në ZVRPP Durrës, ku aplikimi për regjistrimin e pasurisë garazh 10 m² rezultoi se është bërë nga vetë subjekti i rivlerësimit, ndaj pretendimi i subjektit se pasuria garazh mendohej e lidhur me pasurinë apartament banimi nuk është i vërtetë.

24.1 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar me shoqërinë “{***}” ShPK dy kontrata shitblerjeje pasurie në të njëjtën datë, 01.10.2004, njëra për pasurinë “apartament banimi me sip. 146 m²” dhe tjetra për pasurinë “garazh 10 m²”, i ndodhur në katin nën dhe. Gjithashtu, konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2003 dhe as në DIPP-në e vitit 2004 pasurinë e llojit garazh të regjistruar në emrin e tij në vitin 2004. Komisioneri Publik pretendon se nënshkrimi i këtyre kontratave të ndryshme nuk mbështet pretendimin e subjektit, sipas të cilit ai mendonte se dy pasuritë ishin përfshirë në një certifikatë pronësie më vete. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar dy kontrata të cilat kanë të njëjtën datë, por numra të ndryshëm rep. dhe kol. (cituar në paragrafin 23.1 më sipër), në të cilat pasqyrohen çmime të ndryshme për secilën pasuri, ka dy certifikata pronësie të ndryshme, si dhe të dyja pasuritë janë regjistruar më vete në ZVRPP Durrës.

24.2 Në përgjigjet e datës 10.10.2018 të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, subjekti i rivlerësimit në lidhje me pyetjet e Komisionit për këtë mosdeklarim ka sqaruar se: *Sipas porosisë verbale, pra*

marrëveshjes, garazhin e kam konsideruar si pjesë të lidhur me banesën. Në kushtet kur asnjë prej banorëve të pallatit nuk kishte formalizuar kontratë shitblerjeje me ndërtuesin deri në fund të vitit 2004, unë apartamentin dhe garazhin e kam konsideruar si një pasuri të vetme të pandarë, pra e kam quajtur të mirëqenë dhe, si rrjedhim, të deklaruar. Pasi janë përpiluar kontratat në fund të vitit 2004, me të gjithë banorët për mungesë vëmendje kam menduar se ato janë në një certifikatë pronësie të vetme.

24.3 Kolegji vëren se, duke u nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar dy kontrata shitblerjeje, ka marrë dy certifikata pronësie, si dhe duke pasur parasysh që këto kontrata janë formalizuar në një hark kohor të afërt me deklaratën fillestare të vitit 2003 dhe deklarin periodik të vitit 2004, këto janë elemente të mjaftueshme për të sjellë në vëmendjen dhe memorien e subjektit të rivlerësimit që janë dy pasuri të cilat duhen deklaruar më vete në deklaratat e pasurisë. Pavarësisht se objekti i vlerësimit të pasurisë nga Komisioni është deklarimi i pasurive që i përkasin subjektit të rivlerësimit në momentin e deklaratës *vetting*, deklarinet periodike duhet të merren në konsideratë si prova në këtë vlerësim, për shkak se ato mund të hedhin dritë mbi burimet e krijimit të pasurisë dhe në këtë mënyrë edhe mbi ligjshmërinë e pasurisë.

24.4 Në jurisprudencën⁵ e Kolegjit të mbajtur në raste të ngjashme, kontrolli i deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit dhe krahasimi i saj me deklarinet e mëparshme, u shërben Komisionit dhe Kolegjit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarinëve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit të rivlerësimit apo mjaftueshmërinë e deklarinëve të tij. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: *Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.* Në interpretim të dispozitës të mësipërme, qëllimi dhe fryma e Kushtetutës dhe ligjit është e tillë që nga ky proces i rivlerësimit të verifikohen dhe të gjithë ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht apo plotësisht pasuritë e tyre. Ballafaqimi i deklarinëve periodike me ato të bëra në deklaratën “*vetting*” në vitin 2017, u jep mundësi institucioneve të rivlerësimit për të arritur në përfundimin nëse është bërë deklarim i saktë ose i pasaktë i pasurisë, është bërë ose jo fshehje e kësaj pasurie, nëse është i justifikuar burimi i të ardhurave dhe pasurisë së deklaruar etj.

24.5 Sa i përket analizës më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pasurinë garazh në deklaratën fillestare të vitit 2003, si dhe fakti që deklarinet në lidhje me vlerën e apartamentit janë të ndryshme krahasuar me kontratat e shitblerjes, e bëjnë të pamundur identifikimin apo besueshmërinë e versionit që jep subjekti për mënyrën dhe kohën e dakordësisë për këtë objekt lidhur me deklarinin e kësaj pasurie. Pavarësisht këtyre rrethanave, meqenëse është vetëm një deklarim i pasaktë në deklaratën periodike, Kolegji vlerësoi se kjo pasaktësi, nëse qëndron e vetme, nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkakut shkarkimi.

⁵ *Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit: nr. 6/2018 (JR), paragrafi nr. 14; nr. 7/2018 (JR), paragrafët nr. 73, 74; nr. 8/2018 (JR), paragrafi nr. 43; nr. 9/2018(JR), paragrafi nr.42; nr. 10/2018(JR), paragrafi nr. 67; nr. 12/2018(JR), paragrafi nr. 24.11; nr. 9/2019(JR), paragrafi nr.10.1.1; nr. 19/2019(JR), paragrafi nr. 22.4.*

25. Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme nga burime të ligjshme krijimin e pasurisë apartament + garazh. Komisioneri Publik, lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave të ligjshme për krijimin e këtyre pasurive, çmon se bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, nuk duhet të konsiderohen si të ardhura të ligjshme (i) dhurimet⁶ nga të afërmit e subjektit të rivlerësimit, në shumën totale 3.150.000 lekë, si dhe (ii) të përfshihen në analizë shpenzimet e jetesës për periudhën 1992-1997. Në këto kushte, balanca negative e të ardhurave të ligjshme për subjektin e rivlerësimit për periudhën 1992-2003, sipas Komisionerit Publik arrin në vlerën negative 4.230.853 lekë.

25.1 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *vetting* e ka përshkruar këtë pasuri: *Apartament me sip. 146,46 m² dhe garazh sip.10,5 m², me adresë “lagjja {***}, rr. “{***}”, pallati {***}, Durrës.*

Burimi i krijimit: Nga kursimet në vite të të ardhurave dhe pjesëtim vullnetar nga shitja e banesës së prindërve në vitin 2000.

Vlera sipas aktit të porosisë në vitin 2001, 5,5 milionë lekë, ndërsa për arsye të mospërfundimit të banesës në aktet e shitblerjeve vlera e apartamentit (karabina) është 1.700.000 lekë dhe garazhi 250.000 lekë, shpenzime të cilat janë kryer më pas për punimet. Rivlerësuar në vitin 2011, në vlerën 10.933.353 lekë.

25.2 Në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003, subjekti ka deklaruar: *Apartament banimi 3+1, në vlerën: 5,5 milionë lekë, pjesa që zotëron 50%, vendndodhja: Lagjja nr. {***}, Durrës.*
Burimi i krijimit: Nga pjesëtimi vullnetar i një banese në bashkëpronësi dhe kursimet.

25.3 Kolegji konstaton se, i pyetur nga Komisioni nëse ka lidhur kontratë porosie me shoqërinë e ndërtimit, subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e datës 10.10.2018 të pyetësorit nr. 2, ka sqaruar: *Nuk kam lidhur kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “{***}” ShPK në lidhje me apartamentin. Kam qenë në rrethana ku kam porositur verbalisht firmën ndërtuese për apartamentin në fjalë, ku pasi e kam parë, ishte në gjendje të papërfunduar nga brenda, vetëm dera e jashtme pra në fazë karabinaje nga brenda [...]. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, Kolegji vëren se pavarësisht se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar aktin e porosisë në deklaratën *vetting*, nuk rezulton ta ketë në formë të shkruar.*

25.4 Kolegji vëren se në lidhje me burimet e krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e parë në vitin 2003 dhe në deklaratën *vetting* se një nga burimet e blerjes së pasurisë ka qenë pjesëtimi vullnetar i një banese në bashkëpronësi, pa dhënë ndonjë vlerë konkrete të këtij pjesëtimi. I pyetur nga Komisioni për këtë fakt, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka sqaruar se: *Kam biseduar me prindërit që bashkëjetonin dhe me vëllain tim, në lidhje me nevojën që kisha për të ndihmuar për blerjen e apartamentit tim. Babai im S. M., pasi shprehu gatishmërinë për të më ndihmuar, më dhuroi shumën prej 1.500.000 lekësh [...]. Këto të*

⁶ Dhurimet: (i) 1.500.000 lekë nga babai i subjektit; (ii) 1.000.000 lekë nga vjehri; (iii) 300.000 lekë nga kunati, (iv) 350.000 lekë e deklaruar si e ardhur nga ana e bashkëshortes në momentin e martesës, si kursime të saj nga puna dhe dhuratë nga familja.

*ardhura im atë i ka siguruar edhe nga shitja e një apartamenti në qytetin e Durrësit, sipas kontratës noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 22.12.2000. Në vlerësimin e Kolegjit, subjekti i rivlerësimit në deklaratën vetting dhe atë periodike të vitit 2004 kishte detyrimin të deklaronte saktë këto të ardhura që kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë, të cilat i ka lënë të përgjithësuara pa saktësuar shumën që i është dhuruar nga i ati apo i ka rezultuar pjesë takuese si pasojë e pjesëtimit vullnetar nga shitja e banesës së prindërve në vitin 2000. Kjo shumë prej 1.500.000 lekësh, e deklaruar për herë të parë gjatë fazës së hetimit administrativ në Komision, e cila ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë, sipas subjektit të rivlerësimit deklarohet se rrjedh nga dy institute të ndryshme të së drejtës, siç janë “pjesëtimi i pasurisë” dhe “dhurimi”, të cilët dallojnë si nga forma, por edhe nga përmbajtja nga njëra-tjetra. Për pasojë, deklaratimet dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, duke qenë kontradiktore dhe jobindëse, nuk kënaqin kërkesat e nenit D, paragrafi i 3 i Aneksit të Kushtetutës.*

25.5 Kolegji vëren se në parashtrimet e paraqitura gjatë seancës gjyqësore publike më datë 18.03.2021, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: *Kam shpjeguar se me akt pjesëtimi vullnetar në DPV-në e 2004, kam pasur parasysh ndihmën e dhënë nga babai im për blerjen e apartamentit, që përkoj me periudhën kur im atë sapo kishte shitur apartamentin në qytetin e Durrësit, duke pasur të ardhura dhe mundësi për të më ndihmuar. Sqaroj se në shpjegimet e mia, nisur dhe nga fakti i momentit të shitjes së banesës nga babai im, e kam quajtur akt pjesëtimi vullnetar, por jo të formalizuar në ndonjë akt juridik civil.*

25.6 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision deklaratën noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 08.10.2018. Deklarues është babai i subjektit të rivlerësimit, z. S. M., i cili është shprehur saktësisht: *[...] mbi bazën e traditës familjare, me pëlqimin e bashkëfamiljarëve, i kemi mundësuar dhënien në vlerën prej 1.500.000 lekësh, në periudhën në fillim të vitit 2002, pasi kryente dhe punimet për përfundimin e banesës. Vlera e parave të dhëna posedohej nga ana ime mbi bazën e të ardhurave familjare tonat bashkë me djalin tjetër A. M. [...]. Pra, për financimin e dhurimit ishin të ardhurat jo vetëm nga shitja e apartamentit, por edhe të ardhurat e dërguara nga emigracioni, gjatë asaj periudhe, prej vëllait të subjektit të rivlerësimit, shtetasit A. M.*

25.7 Në konkluzion të këtij shkaku ankimi, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm pasi pretendimi i tij dhe konkluzioni i Komisionit, bazuar në këtë pretendim, se kishte mungesë baze ligjore për deklaramin e kontributeve sikundër janë dhuratat, nuk qëndron, për sa kohë që në formularin e deklaramit të parë është specifikuar qartësisht detyrimi për të deklaruar burimin e krijimit të pasurisë. Për sa kohë ky dhurim ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë, subjekti kishte detyrimin ligjor ta specifikonte që në deklaramin para fillimit të detyrës. Përpos këtij elementi, në referencë të kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka përcaktuar në deklaramin e parë të pasurisë vlerën e saktë të përfituar nga pjesëtimi vullnetar, çka e bën këtë burim si të paidentifikueshëm dhe, pavarësisht formës së deklaruar, mund të konsiderohej nëse do të kishim qartësi për shumën e përfituar prej tij, për këtë arsye Kolegji arriti në konkluzionin se nuk provohet

ekzistenca e burimit të ligjshëm për krijimin e të ardhurave të ligjshme për vlerën e deklaruar në formë dhurate nga z. S. M., si rrjedhojë shkakut i ankimit i Komisionerit Publik gjendet i bazuar.

25.8 Kolegji vëren se lidhur me dhurimet e babait të bashkëshortes dhe vëllait të bashkëshortes, të cilat nuk janë deklaruar as në deklaratat periodike dhe as në deklaratën *vetting* nga subjekti i rivlerësimit, por janë pretenduar gjatë hetimit administrativ në përgjigjet e pyetësorëve që ka dhënë subjekti i rivlerësimit në Komision, rezultojnë shumat:

M. M. (vjeherri i subjektit të rivlerësimit) – 200.000 lekë në vitin 1997, 200.000 lekë në vitin 1998, 250.000 lekë në vitin 1999, 350.000 lekë në vitin 2000 dhe 300.0000 lekë për apartamentin e ri në formën e punimeve nga kunati A. M. (vëllai i bashkëshortes). Këto dhurime nuk janë dokumentuar me akte provuese në kohën kur janë dhuruar dhe nuk janë deklaruar në deklaratën fillestare apo *vetting* si burim i krijimit të kësaj pasurie, duke qenë se janë pretenduar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ për krijimin e saj.

25.9 Kolegji konstaton se në shpjegimet e datës 22.06.2019, mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit sqaron se: *Babai i bashkëshortes ka pasur të ardhura në vazhdimësi, duke qenë se ka banesën e tij private (ndërtim italian), si dhe ka pasur të ardhura nga djali i tij A. M., i cili ka jetuar dhe punuar në Greqi që nga viti 1992 me dokumentacion të rregullt bashkë me familjen e tij. Babai i bashkëshortes ka krijuar të ardhura nga kthimi i pasurive në formën e parcelave në sipërfaqen 1091 m² nga KKKP Durrës në vitin 1996. Vjeherri i subjektit të rivlerësimit i ka shitur këto parcela me tri kontratat e shitjes, dy në vitin 1996 dhe një në vitin 2001, duke krijuar të ardhura në shumën 3.240.000 lekë. Të ardhura të tjera i ka përfutuar nga puna e tij si kapiten dhe kryemekanik në portin e Durrësit deri në vitin 2005. Në mbështetje të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në dokumentacionin e administruar në dosje rezulton një deklaratë noteriale me nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 15.06.2019, e z. M. M., vjeherri i subjektit të rivlerësimit, i cili deklaron se për periudhën 1997-2002 i ka dhënë në formën e dhuratës shuma monetare vajzës së tij dhe subjektit të rivlerësimit në vlerën 1.000.000 lekë. Burimi i krijimit të këtyre shumave deklarohet se ka qenë shitja e tri trojeve në pronësi të tij, të ardhurat nga punësimi i tij dhe gjithashtu të ardhurat nga puna e djalit të tij emigrant.*

25.10 Subjekti i rivlerësimit paraqiti gjatë seancave gjyqësore publike në Kolegj disa llogari bankare të kunatit të tij A. M. në shtetin grek, në të cilat specifikohet paga bruto, kontributet e paguara, ditët e punës dhe të dhëna të tjera të të siguruarit për periudhën 2002-2021. Bazuar në deklaratën noteriale të lëshuar nga vëllai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit A. M. me nr. {***} rep dhe nr. {***} kol., datë 15.06.2019, deklarohet se ai i ka dhënë subjektit të rivlerësimit dhe motrës së tij shumën 300.000 lekë në formën e punimeve për apartamentin e tyre.

25.11 Kolegji vëren se Komisioneri Publik, në analizën e provave të paraqitura në Kolegj nëpërmjet parashtrimeve të datës 29.04.2021, vlerësoi se A. M. ka pasur mundësi⁷ të përballonte këtë dhurim

⁷ Nga analiza e provave për të ardhurat e kunatit të subjektit të rivlerësimit në parashtrimin e datës 29.04.2021 të Komisionerit Publik rezulton se të ardhurat bruto të z. M. kanë qenë në vlerën 21.262 euro për vitet 2002-2003 dhe sipas Komisionerit Publik kjo vlerë është e mjaftueshme për të provuar mundësinë financiare të z.M. për dhurimin

në vitet 2002 dhe 2003. Edhe pse në analizën e Kolegjit rezultoi ndryshe nga sa parashtroi Komisioneri Publik, sipas poshtëshënimit nr. 7, situata financiare e z. M. nuk u mor në konsideratë në vendimmarrjen e Kolegjit, pasi ishte e mjaftueshme situata e mosdeklarimit nga ana e subjektit të rivlerësimit të dhurimeve si në deklaratën *vetting* dhe ato periodike. Subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar këto shuma si burim i krijimit të pasurisë, edhe pse në këtë drejtim ka konsistuar detyrimi i tij sipas deklaratave, asaj fillestare dhe *vetting*.

25.12 Në Kolegj u shqyrtuan aktet e administruara në dosjen e Komisionit dhe aktet e reja të sjella nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit gjyqësor. Nga dokumentacioni i siguruar nga subjekti i rivlerësimit nuk u provuan dhurimet si burim për krijimin e pasurisë, dhurime të cilat nuk ishin deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës dhe as në deklaratën *vetting*. Sa i përket burimit të krijimit të dhurimeve nga të afërmit e subjektit të rivlerësimit, me dokumentacionin e vënë në dispozicion gjatë procesit të rivlerësimit në Komision dhe në Kolegj, për sa kohë që këto dhurime nuk ishin deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, ato nuk u analizuan nga trupi gjykues si burime për krijimin e pasurisë apartament, për rrjedhojë Kolegji nuk u ndal në vlerësimin nëse ato justifikoheshin si të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

25.13 Sa i përket mënyrës së pagesës së këtij apartamenti në pyetësin nr. 5, datë 21.11.2018, të dërguar nga subjekti i rivlerësimit në Komision, ai deklaroi mënyrën e pagesës ku kësti i parë është kryer në fund të vitit 2001, menjëherë pas marrëveshjes verbale, në vlerën 1.000.000 lekë dhe kësti i dytë në shumën 950.000 lekë është paguar në fund të vitit 2002. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të kryejë blerjen e apartamentit me sip. 146 m². Në analizë nuk janë përfshirë dhurimet që subjekti ka pretenduar si dhurata nga familjarët, duke qenë se këto dhurime nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e parë të pasurisë dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*. Dhurimet në total pretendohen të jenë në vlerën 3.150.000 lekë. Edhe nëse këto vlera/dhurime të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit do të konsideroheshin si të ligjshme dhe të deklaruara, subjekti i rivlerësimit do të rezultonte përsëri me diferencë negative financiare, duke konsideruar një shpenzim jetese minimal në nivelin 30% të të ardhurave deri në vitin 1998 dhe për vitet në vazhdim shpenzimet e jetesës janë konsideruar sipas publikimeve të INSTAT-it. Në analizën financiare të kryer në Kolegj për periudhën 1992-2003, të ardhurat nga dhurimet nuk u konsideruan si të ligjshme, ndaj rezultati i diferencës mes të ardhurave dhe shpenzimeve për këtë periudhë është në vlerën negative - 3.864.152 lekë. Në Kolegj u kryen të gjitha alternativat e mundshme të varianteve të analizës financiare. Bazuar në mënyrën e shpjeguar më sipër të përlllogaritjes së shpenzimeve, në rastin kur do të konsiderojmë vetëm 1.500.000 lekë si burim krijimi të pasurisë sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit nga dhurimet, atëherë diferenca negative do të ishte 2.364.152 lekë, ndërsa

ndaj subjektit të rivlerësimit. Nga përlllogaritja e kryer në Kolegj, të ardhurat bruto të z.M. kanë qenë në vlerën 21,262 euro ndërsa të ardhurat neto 11,575 euro për vitet 2002-2003. Për të përlllogaritur shpenzimet e jetesës për këtë periudhë janë marrë në konsideratë shpenzimet e jetesës bazuar në faqen e statistikave eurostat, të cilat rezultuan në vlerën 18,374 Euro për vitin 2002 dhe 2003. Në këto kushte, rezulton se të ardhurat e z. M. nuk kanë qenë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e tij të jetesës për vitet 2002-2003 dhe për të krijuar kursime.

nëse do t'i konsideronim vetëm 475.000 lekë si burim krijimi të pasurisë nga pjesëtimi vullnetar, atëherë diferenca negative do të ishte 3.389.152 lekë.

25.14 Në përfundim të analizës së shkaqeve të ankimit për këtë pasuri, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave pasi nuk provoi me dokumentacion justifikues fitimin e shumave të pretenduara prej tij si të dhuruara, duke qenë se ato nuk ishin deklaruar në deklaratën fillestare dhe atë *vetting*, për rrjedhojë ai rezultoi me mungesë burimi të ligjshëm, edhe sikur këto shuma të ekzistonin. Këto dhurime, pasuri e luajtshme, që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 146,46 m² dhe garazh me sip. 10,5 m² nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Shumat e dhuruara që nuk janë deklaruar më parë as në deklaratat periodike dhe as në *vetting*, nuk u provuan edhe gjatë procesit gjyqësor në Kolegj, dhe pretendimet për to të subjektit të rivlerësimit mbetën në nivel deklarativ. Nisur nga kjo situatë faktike, bazuar në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit konsiderohet me mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar pasurinë, kursimet dhe shpenzimet e krijuara në periudhën 1992-2003.

- 26.** Komisioneri Publik ka ngritur shkak ankimi lidhur me mungesën e të ardhurave të ligjshme nga burime të ligjshme për investimin në Fondin e Investimeve “{***}” në shumën 5.500.000 lekë në Raiffeisen Bank, për krijimin e gjendjes *cash* në banesë të deklaruar në shumën 1.200.000 lekë, si dhe për rezultatet e analizës së treguesve financiarë ndër vite.

26.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Për pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike të bëra ndër vite në ILDKPKI, të pasqyruara në rezultatet e hetimit, Komisioni vlerësoi se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit janë bindëse dhe se ato nuk sjellin pasoja në këtë proces, pasi nuk cenojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se, pas analizës financiare të përditësuar, mungesa e likuiditeteve (balancat negative), të shtrira përgjatë viteve, nuk janë në masën që të cenojnë besimin e publikut. Ky përfundim arrihet pasi natyra e analizës financiare është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson, krahasuar me aspektet konkrete të jetës reale. Për sa arsyetohet më sipër, trupi gjykues çmon se mungesa e këtij likuiditeti (balancë negative fondesh) nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.*

26.2 Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar: “Depozitim në Raiffeisen Bank, më datë 29.01.2014, në vlerën 4.000.000 lekë (blerje kuotash), pjesa tjetër prej 2.400.000 lekësh vazhdon të jetë *cash* në banesë, dhe shtuar *cash*-i në banesë nga pagat, 400.000 lekë. Burimi i krijimit: Nga kursimet vjetore të deklaruara periodikisht si *cash* në banesë dhe dy llogaritë bankare 8.000 USD në Intesa SanPaolo Bank dhe 1.079.132 lekë tërhequr nga llogaria e pagës”.

26.3 Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti deklaroi: “Nuk ka shtesa, por me një ndryshim nga gjendja *cash* në banesë, më datë 21.10.2016 është derdhur vlera prej 1.500.000 lekësh në Raiffeisen Bank

(si fond investimi) duke ia shtuar vlerës së mëparshme të deklaruar në vitin 2014. Interesat në këto raste evidentohen në momentin e tërheqjes, pasi variojnë në varësi të ecurisë së bankës”.

26.4 Në deklaratën *vetting*, subjekti deklaroi: “Depozitim në Raiffeisen Bank (fond investimi) 5.500.000 lekë dhe gjendje *cash* në banesë 1.200.000 lekë. Burimi i krijimit: Kursimet nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes, vlera në total 6.700.000 lekë”.

26.5 Nga verifikimi i kryer në Kolegj i pasqyrave të lëvizjeve bankare, ashtu sikurse dhe Komisioni ka konstatuar, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka investuar në Fondin e Investimeve “{***}”, në Raiffeisen Bank shumat: a) më datë 29.01.2014 është investuar shuma 4.000.000 lekë; dhe b) më datë 25.10.2016 është investuar shuma 1.500.000 lekë. Komisioni ka kryer analizën financiare për periudhën 2004-2016, për të vlerësuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të krijuar me të ardhura të ligjshme shumën prej 5.500.000 lekësh investim në Fondin “{***}” pranë Raiffeisen Bank, si dhe mundësinë e kursimit të gjendjes *cash* në banesë në vlerën prej 1.200.000 lekësh. Analiza e treguesve financiarë të Komisionit, referuar rezultateve të hetimit administrativ, ka treguar se subjekti i rivlerësimit për periudhën 2004-2016 rezultoi me një balancë negative fondesh, në vlerën 2.700.059 lekë, rrethanë kjo për të cilën i është kaluar barra e provës.

26.6 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dërguara në Komision lidhur me rezultatet e hetimit, ka depozituar prova të reja duke pretenduar të ardhura shtesë dhe reduktimin e disa shpenzimeve, të cilat Komisioni, pasi i mori pjesërisht në konsideratë, i reflektoi në analizën e treguesve financiarë për vitet 2004-2016, konkretisht: (i) të ardhura shtesë për periudhën janar - maj të vitit 2008; (ii) dhurimet e deklaruara; (iii) reduktimin e shpenzimeve për udhëtimet; (iv) reduktimin e shpenzimeve jetike për vitin 2007; dhe (v) reduktimin e shpenzimeve të transportit. Pas analizës së kryer nga Komisioni duke i marrë parasysh elementet e mësipërme, rezultoi se për periudhën 2004-2016 subjekti i rivlerësimit ka një balancë negative në vlerën -1.383.254 lekë, e cila vjen si pasojë e deklaratës së shtesave të gjendjeve *cash* në vlera të vogla, të cilat janë pakësuar të gjitha në vitin 2007, pra nuk ka ndikuar më tej në gjendjen *cash* ndër vite, e cila ka shërbyer për krijimin e depozitës në Fondin “{***}” dhe gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën *vetting*.

26.7 Në konsideratë të rekomandimit të ONM-së, datë 26.07.2019, për paraqitje ankimi, të Vëzhguesve Ndërkombëtarë, lidhur me këtë çështje është sugjeruar se: *Parametrat e përdorur nga subjekti në llogaritjen e shpenzimeve të tij në kundërshtim të analizës financiare të kryer nga KPK-ja nuk ndjekin një metodologji të besueshme, dhe se subjekti e përdor këtë gjatë gjithë analizës së tij. Si përfundim, deklaratet e subjektit mbi ndryshimet e likuiditeteve përgjatë viteve, tregojnë se ai ka akumuluar burime të cilat nuk arrin t’i justifikojë me të ardhurat e tij. Kjo tregon se subjekti nuk kishte mundësi të akumulonte 2.400.000 lekë në *cash* në fund të vitit 2004 siç ai deklaroi, çka do të thotë se ai nuk arrin të justifikojë shumën prej 1.500.000 lekësh të investuar më dt. 25.10.2016 në Bankën RZB, si dhe shumën e deklaruar si gjendje *cash* me vlerë 1.200.000 në deklaratën “vetting”.*

26.8 Në Kolegj u krye analiza financiare e subjektit të rivlerësimit për periudhën 2004-2016. Nga kjo analizë, rezultatet financiare rezultuan me diferencë negative në vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2009, 2010, 2011, 2014, 2015 dhe 2016. Në analizën e kryer, shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur bazuar në metodologjinë e përdorur nga ILDKPKI-ja, sipas publikimeve të statistikave të INSTAT-it, mbi tregues të anketës së buxhetit të familjes dhe/ose anketës së matjes së nivelit të jetesës.

26.9 Kolegji konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e tij në disa prokurori në qytete të ndryshme të Shqipërisë, si Lezha dhe Vlora përkatësisht në vitet 2009, 2010 dhe 2011. Për vitet 2010 dhe 2011, subjekti i rivlerësimit ka përfituar vlera/shuma monetare në formën e bonusit dhe dietave për rimbursimin e shpenzimeve të karburantit dhe shpenzimeve të tjera. Nga dokumentacioni⁸ i administruar në dosje lidhur me këto vlera, rezulton se ka mospërputhje të përmbajtjes së shkresave sa u përket shumave të përfituara nga subjekti i rivlerësimit. Ai nuk ka deklaruar në asnjë nga deklaratat periodike, gjatë hetimit administrativ apo edhe në Kolegj, si dhe nuk ka dorëzuar dokumentacion ligjor për të provuar shpenzime të kryera gjatë ushtrimit të detyrës larg vendbanimit, me qëllim që në analizën financiare të konsideroheshin kursime të mundshme nga diferenca mes vlerave të përfituara nga bonusi apo dieta me shpenzimet e jetesës gjatë kësaj periudhe, si rrjedhojë dietat dhe bonuset e përfituara në këtë formë nuk janë llogaritur në zërin “të ardhura” në analizën financiare të kryer në Kolegj. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin larg vendbanimit të tij për një periudhë relativisht të gjatë kohore dhe ka përfituar vlerën 695.500 lekë të derdhur në datën 26.05.2011 në llogarinë e tij bankare për vitin 2011, në Kolegj u krye analiza financiare alternative sipas së cilës shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit të rivlerësimit u konsideruan për katër persona dhe për subjektin e rivlerësimit këto shpenzime jetese u përlllogaritën vetëm për 125 ditë të këtij viti, si ditë gjatë të cilave subjekti i rivlerësimit ka qenë pranë familjes së tij. Nga diferenca e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas kësaj metode, viti 2011 rezulton me një diferencë negative në vlerën -131.695 lekë.

26.10 Kolegji vlerësoi se për rastet kur subjekti i rivlerësimit dorëzoi dokumentacion në kuadër të justifikimit të shpenzimeve të kryera për një pjesë të udhëtimeve jashtë Shqipërisë në formën e deklaratës noteriale, u trajtua nga trupi gjykues në kuadër të qëndrimeve⁹ të mbajtura në jurisprudencën e Kolegjit lidhur me këto prova. Vlera provuese e këtyre deklaratave u vlerësua nga trupi gjykues rast pas rasti, në drejtim të pajtueshmërisë së përmbajtjes së deklarimeve të dhëna në to me provat e tjera dhe çdo të dhënë apo informacion të administruar në fashikull gjatë hetimit administrativ në Komision dhe atij në Kolegj. Si rrjedhojë, u reduktuan shpenzimet për udhëtimet jashtë Shqipërisë, për të cilat informacionet në dosjen e administruar nga Kolegji përputheshin si në informacione, ashtu edhe në vlera të deklaruara në pyetësorë nga subjekti i rivlerësimit. Për

⁸ Shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë me nr. {***} prot., datë 16.02.2021; shkresë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë me nr. {***} prot., datë 07.10.2016; llogaria bankare pranë Raiffeisen Bank.

⁹ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr.6/2018(JR), datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36; nr. 11/2019(JR), datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1; nr. 34/2019(JR), datë 02.12.2019, paragrafi 85.2; nr. 23/2020(JR), datë 25.09.2020, paragrafi 26.2; nr. 11/2021(JR), datë 31.03.2021, paragrafi 26.2.

udhëtimet për të cilat subjekti kishte deklaruar në mënyrë kontradiktore vlerën e tyre gjatë procesit të rivlerësimit apo dokumentacioni i paraqitur nuk përputhej me deklaratimet e tij gjatë këtij procesi, përlllogaritjet nuk u ndryshuan.

26.11 Në analizën e kryer për këtë shkak ankimi, në Kolegj janë konsideruar të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij nga pagat, bazuar në vërtetimet përkatëse, pa përfshirë të ardhurat e përfituara nga subjekti në formën e dietës apo bonusit të karburantit. Në parashtrimet e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore publike në Kolegj të datës 18.03.2021, është paraqitur analiza për situatën e tij financiare vit pas viti, e cila rezultoi me një diferencë shumë të vogël negative për shkak të reduktimit të pjesës më të madhe të shpenzimeve nga ana e subjektit të rivlerësimit. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj për periudhën 2004-2016, rezultoi një diferencë negative më e ulët se ajo e pretenduar nga Komisioneri Publik për shkak të analizimit dhe konsiderimit të disa prej provave të sjella nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj.

26.12 Sa i përket analizës financiare për vitin 2007, në Kolegj rezultoi se të ardhurat nga pagat për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij, të ardhurat nga interesat bankarë dhe të ardhurat nga dhurimet e të tretëve¹⁰ krahasuar me shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për të njëjtin vit janë të pamjaftueshme për të justifikuar mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve. Në lidhje me shumën prej 350.000 lekësh, të gjendur në gjendjen e llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, ky i fundit pretendoi në parashtrimet e tij në Kolegj se: *Për sa i përket shumës 350.000 lekësh, ju bëj me dije se për këtë shumë mosdeklarimi ka ardhur për shkak të harresës gjatë viteve, por që lehtësisht burimet e kësaj shume provohen se janë të ligjshme. Për më tepër, shumën e sipërcituar ka rrjedhur si pjesë e trashëguar nga të ardhurat e bashkëshortes. Për më tepër, referuar dokumentit statement të BKT-së, shumën prej 350.000 lekësh është depozituar më datë 14.04.2006, por dhe tërhequr në datë 18.04.2006. Pra, kjo shumë nuk mund të vlerësohet si e ardhur, por është një xhirim i brendshëm, nga cash në bankë dhe anasjelltas nga banka në cash (brenda 4 ditëve). [...] Në lidhje me shumën prej 250.000 lekësh të kaluara nga babai i bashkëshortes, ju shpjegoj se është e vërtetë se nuk është deklaruar, porse kjo ka qenë një pakujdesi e bashkëshortes e ardhur për shkak të lëvizjeve nga ana e saj në llogari. Në tabelën tonë të depozituar në gjykimin në shkallë të parë, kjo shumë është përfshirë në zërin dhurata në cash.*

26.13 Kolegji vëren se, pas verifikimit të dokumentacionit bazuar në llogarinë bankare në BKT të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, konstatohet depozitimi i vlerës *cash* 350.000 lekë në datën 14.04.2006. Sipas *statement*-it të kësaj llogarie, kjo shumë kalon në depozitë të re në datën 18.04.2006, duke u debituar nga llogaria rrjedhëse si një veprim automatik i cili menjëherë kalon në depozitë. Kjo depozitë është maturuar në datën 19.02.2007 dhe së bashku me interesat e përfituar ka arritur vlerën 356.144,66 lekë. Për këtë arsye pretendimi i subjektit të rivlerësimit se

¹⁰ Dhurimi i shumës 500 euro nga kunati i subjektit të rivlerësimit për 10-vjetorin e ditëlindjes së djalit të subjektit të rivlerësimit, i deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2007.

kjo vlerë është tërhequr në datën 18.04.2006 nuk qëndron. Në të njëjtën llogari bankare, në datën 01.02.2007 rezulton një derdhje në vlerën 250.000 lekë nga babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Kjo shumë është tërhequr nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në datën 19.02.2007, në të njëjtën ditë që është tërhequr edhe depozita e maturuar dhe shpjeguar më sipër. Kjo shumë nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit apo bashkëshortja e tij në DIPP-në e vitit 2007 si e ardhur apo si dhurim. Në analizën financiare të kryer në Kolegj, kjo shumë është konsideruar si e shpenzuar gjatë vitit 2007.

26.14 Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar gjatë procesit administrativ në Komision se për vitin 2011 të konsiderohen si të ardhura edhe vlerat e dietave të dhëna nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Vlerat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit në formën e dietave apo shpërblimeve për mbulimin e shpenzimeve të karburantit për ushtrimin e detyrës në qytete larg banesës kanë destinacion mbulimin e shpenzimeve për nevoja ushqimore, transporti apo fjetjeje të kryera gjatë dhe për shkak të ushtrimit të detyrës, ndaj në analizën financiare të kryer në Kolegj nuk janë konsideruar në zërin e të ardhurave, por janë reduktuar shpenzimet e jetesës për subjektin e rivlerësimit gjatë vitit 2011, duke mos konsideruar për vitin e plotë shpenzimet e tij. Nga analiza financiare e këtij viti, rezultoi se të ardhurat nga pagat për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij dhe të ardhurat nga interesat bankarë, krahasuar me shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për të njëjtin vit, janë të pamjaftueshme për të justifikuar mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve.

26.15 Kolegji vëren se në janar të vitit 2014 subjekti ka kryer investimin në vlerën 4.000.000 lekë në fondin e investimit në Raiffeisen Invest. Mënyra e krijimit të këtij fondi investimi është tërheqja e gjendjeve të dy llogarive bankare të mbartura vit pas viti dhe gjithashtu pakësimi i gjendjes *cash* të deklaruar në banesë në vitet e mëparshme. Nga analiza financiare për vitin 2014, rezultoi se të ardhurat nga pagat për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij, krahasuar me shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për të njëjtin vit, janë të pamjaftueshme për të justifikuar mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve.

26.16 Për vitin 2015, në Kolegj rezultoi se të ardhurat nga pagat për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij, të ardhurat nga interesat bankarë dhe të ardhurat nga dhurimet e të tretëve¹¹ krahasuar me shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për të njëjtin vit, janë të pamjaftueshme për të justifikuar mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve.

26.17 Kolegji vëren se në vitin 2016 është shtuar balanca e fondit të investimit në Raiffeisen Bank në vlerën 1.500.000 lekë nga pakësimi i gjendjes *cash* të deklaruar vit pas viti. Nga analiza financiare për këtë vit, rezultoi se të ardhurat nga pagat për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij, krahasuar me shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për të njëjtin vit, janë të pamjaftueshme për të justifikuar mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e kursimeve.

¹¹ Në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë, në rubrikën e të dhënave konfidenciale, subjekti ka deklaruar dhurimin e shumës 3000 euro nga vjehri i tij për pagesën e studimeve të vajzës së subjektit.

26.18 Pas përfundimit të analizës financiare sipas shkakut të ankimit të ngritur nga Komisioneri Publik, Kolegjit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk mund të mbulonte shpenzimet, kursimet dhe pasuritë për vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2009, 2010, 2011, 2014, 2015, 2016 me një diferencë negative më të ulët se nga Komisioneri Publik, për shkak të konsiderimit të disa prej provave të sjella nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, diferencë negative e cila rezulton në shumën 2.945.544 lekë, si rrjedhojë subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

27. Komisioneri Publik pretendon për pasurinë e luajtshme autoveturë e markës “Ford”, me targë {***}, në pronësi të z. A. L., se subjekti i rivlerësimit në lidhje me përdorimin e automjetit në fjalë, është në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe fshehjes së ushtrimit të të drejtave mbi këtë send.

27.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë çështje: *Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerëson se deklarimet e subjektit lidhur me pronësinë dhe me përdorimin e këtij automjeti duken bindëse. Rezultoi e provuar se shtetasi A. L. është pronari i dy automjeteve dhe ka pasur mundësi financiare për blerjen e tyre. Nuk disponohen të dhëna që shtetasi i sipërcituar, i cili i ka dhënë në përdorim këtë automjet, të jetë me rekorde kriminale, i përfshirë në krimin e organizuar ose i dyshuar si i përfshirë në krimin të organizuar. Komisioni konstaton se nuk qëndrojnë dyshimet e ngritura paraprakisht me rezultatet e hetimit.*

27.2 Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, nuk ka deklaruar pasuri të luajtshme në pronësi apo përdorim të tij apo të personit të lidhur. Gjatë hetimit administrativ në Komision, rezultoi se në përgjigje të pyetësorit të datës 21.05.2018, dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ai dhe bashkëshortja e tij kanë përdorur automjetin në pronësi të shtetasit A. L., të markës “Ford”, me targë {***}, për raste të veçanta udhëtimi, kryesisht për lëvizje familjare.

27.3 Kolegji vëren se Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse në lidhje me të drejtat pasurore të tij mbi këtë automjet dhe mbi dyshimet e ngritura se subjekti ka ndërmarrë hapa dhe është përpjekur të fshehë pasuri në pronësi apo në përdorim të tij. Në shpjegimet për rezultatet e hetimit, datë 22.06.2019, subjekti i rivlerësimit lidhur me automjetin në përdorim, ka sqaruar se: *Ky automjet është në pronësi të shtetasit A. L., shok dhe mik i familjes sime, fakt i njohur botërisht në komunitetin ku unë jetoj. Dua të sqaroj se këtë automjet e kam përdorur disa herë, në vitet 2015 – 2016, për periudha të shkurtra kohore (disaditore) për udhëtime të gjata, kryesisht për udhëtimet drejt Tropojës (për shkak të lidhjeve familjare), nisur dhe nga fakti i terrenit të asaj zone. Sqaroj se në këto udhëtime kam ndjekur itinerarin nëpërmjet Kosovës, duke dalë në pikën kufitare të Qafë Morinës, Kukës dhe duke hyrë përsëri në pikën kufitare Morinë-Tropojë. Duke iu referuar sistemit TIMS, rezulton se numri i udhëtimeve me këtë automjet është më i reduktuar se ai i evidentuar nga ana juaj, ku më rezultojnë gjithsej 23 udhëtime në katër vite dhe, duke qenë kryesisht në lëvizje për në Tropojë, ku për shkak të specifikës së itinerarit brenda ditës shënohet dhe hyrja dhe dalja, të krijohet ideja e një numri të madh udhëtimesh. Referuar udhëtimeve të kryera me këtë mjet, rezulton qartë se është përdorur rreth 5-6 herë në vit dhe është fakt që është marrë vetëm në rastet e udhëtimeve të gjata [...]”.*

27.4 Kolegji vëren se lidhur me përdorimin e këtij automjeti, Vëzhguesit Ndërkombëtarë kanë mbajtur këtë qëndrim: “Shpjegimet e tij nuk paraqesin prova kundërshtuese, si dhe nuk i

përgjigjen faktit se përdorimi i mjetit nuk ishte deklaruar asnjëherë, dhe as nuk figuron që ky mjet ishte përdorur intensivisht nga ai dhe familja e tij, e cila e bën *de facto* në pronësi të tyre, e cila duhet të ishte deklaruar në deklaratën *vetting*. Në fakt:

i. Shpjegimet e subjektit fokusohen vetëm në pronësi “fiktive” të mjetit dhe nuk përgjigjet për mosdeklarimin e përdorimit të këtij mjeti.

ii. Argumenti kryesor i përdorur nga subjekti se numri i lartë i TIMS-ave është si pasojë e shumë kalimeve të udhëtimeve të tij në Tropojë, dhe pretendon se përdorimi i këtij mjeti jashtë vendit shkon deri në 23 herë, ai shpjegon se përderisa ka një mjet shtetëror, nuk ka nevojë për një të dytë.

iii. Një analizë e thelluar e të dhënave TIMS, si dhe një analizë krahasuese e përdorimit të këtij mjeti, tregon se subjekti e ka përdorur këtë mjet në një numër të madh rastesh, duke e përdorur edhe në destinacione të tjera përveç Tropojës.

iv. Duke marrë parasysh këtë përdorim të gjerë, është e dukshme se pronari formal A. L. nuk e ka përdorur kurrë këtë mjet në ndonjë udhëtim jashtë vendit. Kjo dëshmon përdorimin e këtij mjeti ekskluzivisht nga subjekti”.

27.5 Kolegji konstaton se nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, ndër të tjera gjenden të dhëna mbi polica sigurimi, të nxjerra nga sistemi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që rezultojnë të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur, ku rezultojnë si përdorues të siguruar të automjetit tip “Ford”, si dhe të dhëna mbi lëvizjet ndërkufitare me këtë mjet, nxjerrë nga sistemi TIMS për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur. Nga verifikimi i këtyre akteve, rezulton se duke iu referuar policave të sigurimit, automjeti tip "Ford Explorer", me targë {***} është në pronësi të z. A. L. Nga policat e sigurimit të llojit “{***}”, që është siguracioni i detyrueshëm i mjetit me targë shqiptare për qarkullim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, rezultoi se ka qenë i shënuar si përdorues subjekti i rivlerësimit në periudhën korrik 2015 deri në korrik 2017, rinovuar në korrik të 2016-ës. Më pas, në policën e sigurimit të këtij automjeti, të prerë për periudhën nga korriku 2017 deri në korrik 2018, rezulton përdoruese e automjetit bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit.

27.6 Kolegji vëren se të dhënat e nxjerra nga sistemi TIMS, konfirmojnë se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë kaluar kufirin shqiptar me këtë automjet disa herë. Saktësisht, subjekti i rivlerësimit rezultoi për periudhën nga viti 2014-2019 me rreth 45 hyrje dhe dalje në total. Bashkëshortja e tij rezultoi nga sistemi TIMS me 11 hyrje dhe dalje në total për periudhën 2014-2016 dhe 2019. Tre fëmijët e tyre gjithashtu rezultojnë me hyrje dhe dalje me këtë automjet në kufirin shqiptar për periudhën 2014-2017. Gjithashtu nga të dhënat e këtij sistemi rezultoi se në vitin 2014, ka hyrë në territorin e Shqipërisë me të njëjtin automjet edhe vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. A. M. Siç rrjedh nga dokumentacioni i administruar në dosje, ky automjet është përdorur në mënyrë frekvente nga familja e subjektit të rivlerësimit, për dalje jashtë territorit të Shqipërisë. Nga ana tjetër, nga policat e sigurimit të detyrueshëm për qarkullim brenda territorit të Shqipërisë që i përkasin këtij mjeti, figurojnë si përdorues edhe subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, për periudhat e cituara në paragrafin më sipër.

27.7 Kolegji vëren se në parashtrimet e dorëzuara në Kolegj më datë 18.03.2021, subjekti i rivlerësimit shpjegon se udhëtimet e shumta të realizuara me këtë automjet, të rezultuara gjatë hetimit administrativ nga të dhënat e sistemit TIMS, kanë të bëjnë me faktin se ka udhëtuar shpesh me destinacion Tropojën për shkak të lidhjeve familjare (arsye për të cilën ka hyrë dhe ka dalë nga kufiri me Kosovën), sqarime të cilat nuk gjejnë mbështetje nga përmbajtja e dokumentacionit që ndodhet në dosje, sipas të cilit rezultoi se subjekti i rivlerësimit e ka përdorur automjetin edhe në

destinacione të tjera jashtë territorit të Shqipërisë, nëpërmjet kufijve të Hanit të Hotit, Kapshticës, Kakavijës dhe Muriqanit.

27.8 Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision deklaratën noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.06.2019, të A. L. (pronarit të automjetit), sipas së cilës ky i fundit ka deklaruar se është pronari i ligjshëm i automjetit të markës “Ford”, me targë {***}, të cilin e disponon që nga viti 2014. Për shkak të rrethanave të njohjes dhe të miqësisë me subjektin e rivlerësimit, ai deklaroi se ia ka dhënë në disa raste automjetin për të kryer ndonjë udhëtim për qëllimet e tij personale, duke evidentuar faktin se automjetin, subjekti i rivlerësimit e ka marrë vetëm në raste të veçanta dhe jo në përdorim të vazhdueshëm, kryesisht për rrugë të gjata të cilat kanë qenë në Kosovë dhe Tropojë. Lidhur me këtë dokument të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për të provuar përdorimin e mjetit, sjellim në vëmendje qëndrimet që ka mbajtur Kolegji në jurisprudencën e tij në çështje të ngjashme, sipas të cilave deklarata noteriale, megjithëse nuk është e pavlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia e saj provuese në këtë proces nuk është bindëse, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështetet nga rrethanat apo provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit.

27.9 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar gjatë seancave gjyqësore publike në Kolegji printime nga sistemi TIMS për hyrje-dalje të z. A. L., si dhe printime nga ky sistem për hyrje-dalje për vetë subjektin e rivlerësimit, policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, me nr. serie {***}, njësia me origjinalin e deklaratës noteriale me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 24.01.2017 (dy ditë para plotësimit të deklaratës *vetting*, datë 26.01.2017) e A. L., i cili ka deklaruar se prokura e posaçme për dhënie në përdorim të makinës në vitin 2014, është anuluar dhe nuk përdoret më prej subjektit të rivlerësimit. Megjithëse subjekti i rivlerësimit ka sjellë këtë deklaratë noteriale nga A. L., ku sipas përmbajtjes së saj nga janari i vitit 2017 nuk përdoret më nga subjekti i rivlerësimit, në fletë printimet e ekstraktuara nga sistemi TIMS, rezultoi se ai ka vazhduar ta përdorë këtë mjet edhe në prill, maj dhe qershor të vitit 2017, si dhe në shkurt të vitit 2018. Si rrjedhojë, këto prova të sjella nga subjekti i rivlerësimit nuk ndryshojnë situatën e provueshmërisë lidhur me këtë shkak ankimi të Komisionerit Publik.

27.10 Kolegji vlerëson se lidhur me situatën faktike të përdorimit të automjetit prej subjektit të rivlerësimit të rezultuar gjatë hetimit në Komision, ai kishte detyrimin të deklaronte këtë marrëdhënie në deklaratën *vetting*, në zbatim të përcaktimeve të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, në të cilën jepet përkufizimi i fjalës “pasuri”, ku parashikohet se: *Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Ky parashikim, i parë në harmoni me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, detyron subjektin e rivlerësimit të deklaronte përdorimin e këtij automjeti si një pasuri në përdorim të tij – sjell detyrimin e subjektit të rivlerësimit për ta deklaruar si pasuri në përdorim përderisa nga policat e sigurimit sipas sistemit të AMF-së, ai rezultonte se kishte të drejta*

përdorimi mbi këtë automjet për periudhën e sigurimit 12.07.2016 – 11.07.2017, periudhë e cila përfshin brenda saj kohën e depozitimit të deklaratës së pasurisë *vetting* në datën 26.01.2017.

27.11 Kolegji çmon se në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting* (26.01.2017), provohet nga aktet e fashikullit gjyqësor se subjekti i rivlerësimit ka pasur në përdorim automjetin në fjalë, sikundër dhe rezultoi që të ketë pasur një policë sigurimi {***} të vlefshme në këtë moment kohor, kjo situatë çon në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është në shkelje të detyrimit të deklarimit sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me pasuritë në përdorim. Nga sa u analizua më sipër, nga tërësia e rrethanave rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti në deklaratimet periodike dhe *vetting*. Në përfundim të analizës së këtij shkak ankimi të ngritur nga Komisioneri Publik, subjekti i rivlerësimit në lidhje me mosdeklarimin e përdorimit të automjetit në fjalë është në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të paplotë të pasurisë në përdorim, në kundërshtim me sa parashikohet në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës.

28. Kolegji, pasi dëgjoi edhe konkluzionet përfundimtare të Komisionerit Publik dhe të subjektit të rivlerësimit, vlerësoi të gjitha shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të pasurisë, bazuar në aktet e administruara në dosjen gjyqësore të përbërë nga aktet e përcjella në Kolegj nëpërmjet fashikullit të Komisionit, dhe aktet e depozituara në cilësinë e provës nga subjekti i rivlerësimit, si dhe bazuar në legjislacionin e zbatueshëm, arriti në konkluzionet e mëposhtme.

- I. Lidhur me pasuritë “apartament banimi” me sipërfaqe 146,46 m² dhe “garazh” 10,5 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Durrës, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar krijimin e këtyre pasurive, kursimet dhe shpenzimet e kryera.
- II. Lidhur me Fondin e Investimeve “{***}” në shumën 5.500.000 lekë në Raiffeisen Bank dhe shumën në gjendjen *cash* 1.200.000 lekë dhe mundësinë e krijimit të këtyre likuiditeteve, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimit financiar të ligjshëm për të justifikuar krijimin e këtyre shumave.
- III. Lidhur me përdorimin e automjetit të markës “Ford”, me targë {***}, rezultoi se subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* nuk ka deklaruar në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, ndaj ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë të pasurisë në përdorim.

Kolegji, bazuar në përfundimet e mësipërme, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë vendimi i Komisionit nr. 173, datë 01.07.2019, me të cilin është vendosur konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit Artan Madani duhet ndryshuar, pasi nuk gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte, prova dhe ligj.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 173, datë 01.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Artan Madani, dhe shkarkimin e tij nga detyra.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 12.05.2021, ora 10:00, në Tiranë.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATOR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi